



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 26 , datë 16.09.2020

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZOTIT ARTAN SPAHIU NË VENDIN  
VAKANT PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA  
PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 22.11.2019**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

<b>Vitore Tusha</b>	- Zëvendëskryetare
<b>Fiona Papajorgji</b>	- Anëtare
<b>Arta Marku</b>	- Anëtare
<b>Miranda Andoni</b>	- Anëtare / Relatore
<b>Saida Dollani</b>	- Anëtare
<b>Ludovik Dodaj</b>	- Anëtar
<b>Fatjona Memçaj</b>	- Anëtare
<b>Arjan Qafa</b>	- Anëtar

Asistuar nga sekretare Dorina Dulaj,

Me praninë e Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- zotit Bledar Dervishaj dhe zonjës Katrin Treska, përfaqësuesit e autorizuar të Presidentit të Republikës,

- zonjës Mimoza Arbri, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

**në mbledhjen e datës 16.09.2020**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATIT PËR GJYQATAR**

**NË GJYKATËN KUSHTETUESE: Zoti Artan Spahiu**

**OBJEKTI:**

**Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të zotit Artan Spahiu në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.**

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoji relatimin e anëtares së Këshillit, zonjës **Miranda Andoni**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të Nenit 125 të Kushtetutës dhe të Nenit 7/b të Ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 8577/2000), Presidenti i Republikës, në datën 22.11.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore, të përcaktuara në Nenin 7/a të ligjit Nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe zoti Artan Spahiu.

4. Në zbatim të Nenit 228 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji nr. 115/2016) dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 2, datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit, zhvilluar në datën 15.01.2020, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për vendin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese.

5. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Miranda Andoni.

6. Në datën 16.01.2020, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Zoti Artan Spahiu, është njoftuar për fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturës dhe për detyrimin për tu paraqitur pranë Këshillit për pajisjen me formularë dhe autorizimet përkatëse për kryerjen e kësaj procedure verifikimi. Njoftimi i kryer në rrugë elektronike, në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Artan Spahiu, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

7. Në datën 20.01.2020, kandidati Artan Spahiu është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimin e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 24.01.2020, kandidati Artan Spahiu ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

9. Për verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 235 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën Nr.34 Prot., datë 30.01.2020, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit Nr. 8577/2000 dhe Ligjit Nr. 115/2016.

10. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Artan Spahiu, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

11. ILDKPKI-ja, në zbatim të Nenit 235 të ligjit Nr.115/2016, të ligjit të ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike*” (në vijim ligji nr. 9049/2003) dhe ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*” (në vijim ligji nr. 9367/2005), me shkresën Nr. 132/25 Prot., datë 04.03.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Artan Spahiu dhe personat e lidhur me të, ku në përfundim të analizës së hollësishme financiare ka konkluduar se:

- a) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
- b) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.*
- c) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
- ç) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*
- d) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

12. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të Nenit 229 dhe 235 të ligjit Nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe

detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Artan Spahiu dhe personave të lidhur me të.

13. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Artan Spahiu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 18.02.2020 dhe datën 19.02.2020, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka Societe Generale, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Tirana Factoring & Lease, (15) Tranzit sha, (16) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

14. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara më sipër, në pikën 13, kanë dërguar pranë Këshillit, përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Artan Spahiu.

15. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 236 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën Nr. 35 Prot., datë 30.01.2020, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Artan Spahiu sipas ligjit Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (në vijim ligji nr. 138/2015).

16. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën Nr. 211/322 Prot., datë 08.06.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Vendimin datë 08.06.2020 “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Artan Shkëlqim Spahiu”, me të cilën është vendosur të miratohen rezultatet e verifikimit si më poshtë:

- a) Rezultoi të mos ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të ndryshme nga ato të deklaruara në formular.

- b) *Nuk rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e ndonjë vepre penale, nga autoritetet gjyqësore shqiptare.*
- c) *Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.*
- d) *Nuk rezultoi të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale.*
- e) *Nuk rezultoi të ketë qenë i siguruar me ndonjë masë shtrënguese të sigurisë personale.*
- f) *Nuk ka qenë ndonjëherë në kërkim ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale*
- g) *Nuk është marrë ndaj tij masa e dëbimit nga një shtet i huaj.*

17. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Artan Spahiu, në zbatim të shkronjës “ç” të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 236 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa Nr. 37 Prot., datë 30.01.2020*) dhe me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa Nr. 38 Prot., datë 30.01.2020*).

18. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me aktin shkresor Nr. 581 Prot., datë 28.02.2020, është përgjigjur se:

a) *Në përfundim të procedurave të verifikimit, nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 89 gërmat “a” dhe “c” për integritetin e figurës së z. Artan Spahiu.*

19. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka dërguar përgjigje, me shkresën Nr. 360/4 Prot., datë 09.09.2020, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Artan Spahiu:

- a) *Nuk është i regjistruar në strukturat e Policisë së Shtetit për veprimtari kriminale ose të administrohen të dhëna për kontakte të papërshtatshme.*
- b) *Edhe verifikimet e kryera në arkivat e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, nuk rezulton se në ngarkim të kandidatit për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, të disponohen të dhëna apo materiale të procesit informativ për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.*

20. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të Nenit 229 dhe 236 të Ligjit Nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit Nr. 45/2015 “*Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*” (në vijim ligji nr. 45/2015), si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën Nr. 36 Prot., datë 30.01.2020, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të

plotësuar sipas ligjit nga kandidati Artan Spahiu për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

21. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën Nr. 137/5 Prot., datë 17.02.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vendimin Nr. 74, datë 13.02.2020, me të cilin ky institucion ka vendosur të informojë KED-në se:

a) *Për zotin Artan Shkëlqim Spahiu, nga verifikimet e kryera deri tani nuk figurojnë të ketë materiale në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas Nenit 29, pika 2 të ligjit Nr.45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".*

22. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave "b", "c" dhe "d" të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 237 dhe 240 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Artan Spahiu në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

23. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "c" e pikës 1 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli, në datën 12.08.2020, i është drejtuar përsëri KQZ-së për listën e partive politike, si dhe në datën 02.07.2020, datën 20.08.2020 dhe datën 21.08.2020 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në përgjigje të këtyre kërkesave, ato parti politike të cilat kanë kthyer përgjigje, kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Artan Spahiu.

24. Gjithashtu për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi t'i drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekteve private, pranë të cilave kandidati Artan Spahiu ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit si Prefekti i Qarkut Elbasan (*shkresa Nr. 143 Prot., datë 09.07.2020*), Këshilli i Qarkut Elbasan (*shkresa Nr. 142 Prot., datë 09.07.2020*), Universiteti i Elbasanit "*Aleksandër Xhuvani*" (*shkresa Nr. 144 Prot., datë 09.07.2020*).

25. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Prefekti i Qarkut Elbasan (*shkresa Nr. 904/1 Prot., datë 13.07.2020*), Këshilli i Qarkut Elbasan (*shkresa Nr. 488/1 Prot., datë 14.07.2020*), Universiteti i Elbasanit "*Aleksandër Xhuvani*" (*shkresa Nr. 1229/1 Prot., datë 17.07.2020*).

26. Me shkresën e datës 27.07.2020, Këshilli i ka kërkuar kandidatin të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë në lidhje me pozicionin e punës, e konkretisht nëse pozicionet e punës së deklaruar nga ana e tij mund të barazohen me pozicionet e kërkuara në kuptim të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000.

27. Kandidati Artan Spahiu, ka paraqitur me shkrim shpjegimet dhe dokumente shtesë pranë Këshillit, në rrugë elektronike, në datën 28.07.2020.

28. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të Neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit Nr. 115/2016, si edhe të pikave 30, 95, 96 të Vendimit Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, anëtari i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

29. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, zv/Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj, në datën 16.09.2020, ora 11:00, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja: Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin Artan Spahiu për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

30. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Artan Spahiu.

31. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

32. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 16.09.2020, ora 11:00, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

33. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

34. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Artan Spahiu.

35. Avokati i Popullit, në lidhje me kriterin e vjetërsisë, rekomandoi thellimin e procedurës për verifikimin e kësaj shtese, edhe pse kandidati nuk ka paraqitur dokumente shtesë pas kërkesës së bërë nga Këshilli. Po ashtu, Avokati i Popullit rekomandoi se Këshilli duhet të thellojë hetimin edhe në lidhje me kriterin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit nga ana e kandidatit, bazuar në të dhënat e deklaruara nga ai vetë, si edhe bazuar në raportin e ILDKPKI-së, hetim i cili nuk është i nevojshëm të kryhet në rast të një vlerësimi negativ për kriterin e vjetërsisë nga ana e Këshillit.

## **II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

36. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Artan Spahiu për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

37. Në pikën 4 dhe 5 të Nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

*“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*

*5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”*

38. Në pikën 1 dhe 2 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, parashikohet se:

*“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:*

*a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*

*b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*

*c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*

*ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*

*d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*

*dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

*2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij Neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:*

*a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*

*b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*

*c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.*

39. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 të Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Artan Spahiu ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1995- 1999 si Jurist, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “A.Xhuvani” Elbasan. Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë, kandidati Artan Spahiu plotëson këtë kusht sipas dispozitave të sipërcituara.



40. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, rezulton se kandidati Artan Spahiu ka ushtruar veprimtari profesionale si më poshtë:

a) *Jurist, për periudhën “10 Gusht 1999 – 28 Mars 2010”, pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, konkretisht:*

- 10 Gusht 1999 – 01 Qershor 2000, *Inspektor Jurist pranë Zyrës Juridike.*

- 02 Qershor 2000 – 04 Janar 2005, *Jurist në Drejtorinë e Kontrollit Financiar.*

- 05 Janar 2005 – 01 Maj 2006, *Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Financiar.*

- 02 Maj 2006 – 28 Mars 2010, *Inspektor Jurist në Sektorin e Auditit të Brendshëm.*

b) *Drejtor i Drejtorisë Juridike, për periudhën “06 Maj 2010 – 21 Tetor 2010”, pranë Këshillit të Qarkut Elbasan.*

c) *Pedagog, për periudhën “01 Nëntor 2010 - e në vijim”, pranë Universitetit “A.Xhuvani” Elbasan.*

41. Kandidati Artan Spahiu, në datën 28.07.2020 ka dhënë shpjegime nëpërmjet rrugës elektronike nëse pozicionet e punës të deklaruar prej tij plotësojnë kërkesën e Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, në thelb të të cilave, parashtron:

*Së pari, ... Afati minimal 15 vjeçar duhet të llogaritet si përmbledhje e të gjitha periudhave të punësimit me kohë të plotë. Në këtë kuptim, **eksperiencia ime e punës 20 vjeçare (deri në momentin e kandidimit) e justifikon kërkesën e normës, përsa i përket afatit minimal 15 vjeçar, të kërkuar.***

*Së dyti, Prefekti i Qarkut dhe Këshilli i Qarkut, janë organe të administratës publike, prandaj periudha e punësimit në këto organe (Gusht 1999 – Tetor 2010) konsiderohet si periudhë punësimi në administratën publike,*

*- **Pozicionet e punës që kam mbajtur në administratën e Prefektit të Qarkut dhe Këshillit të Qarkut Elbasan, konsiderohen si pozicione “jurist i nivelit të lartë”.** ... punësimi në administratën e Prefektit të Qarkut Elbasan, për periudhën kur unë kam qenë i punësuar, nuk rregullohej nga ligji i shërbimit civil, por nga Kodi i Punës. Struktura ka qenë e organizuar fillimisht në “zyra” (më përjashtim të Drejtorisë së Kontrollit Financiar) dhe më pas në “sektorë”. Nuk ka patur dhe nuk ka “Drejtori Juridike” apo “Departament Juridik” në administratën e organit të Prefektit të Qarkut. Për rrjedhojë pozicioni i punës “Jurist”, për periudhën “Gusht 1999 – Qershor 2000” dhe Audit (jurist), për periudhën “Qershor 2000 – Mars 2010”, në administratën e Prefektit të Qarkut Elbasan, duhet të konsiderohen si pozicione pune “jurist i nivelit të lartë”, përsa kohë nuk ka patur struktura me pozicione pune më të larta si “jurist” në aparatin administrativ të organit të Prefektit.*

*Së treti, ... në nivel qarku, pozicioni i juristit të Prefektit konsiderohet si pozicion i “nivelit të lartë”, për shkak të pozicionit shumë të rëndësishëm ligjor që kishte organi i Prefektit. ... edhe në kuptimin e rëndësisë së detyrave dhe përgjegjësive që kam ushtruar, pozicionet e punës “Jurist” në administratën e Prefektit të Qarkut Elbasan, duhet të konsiderohen si pozicione pune “jurist i nivelit të lartë”.*

*Së katërti, sa i përket punësimit në administratën e Këshillit të Qarkut Elbasan, për periudhën kur unë kam qenë i punësuar, marrëdhëniet e punës rregulloheshin nga ligji i shërbimit civil. Punësimi si “Drejtor i Drejtorisë Juridike”, për periudhën “Prill 2010 –*

*Tetor 2010”, pranë Këshillit të Qarkut Elbasan duhet të konsiderohet si pozicion pune “jurist i nivelit të lartë”.*

**iii. Punësimi për periudhën “Nëntor 2010-Dhjetor 2019”, si pedagog (lektor), pranë Universitetit “A.Xhuvani” Elbasan, plotëson kërkesën e përvojës së punës si “lektor i së drejtës”.**

42. Bazuar në këto të dhëna, kandidati Artan Spahiu vlerëson se ka gjithsej 20 vite eksperiencë në punë dhe se pozicionet e punës që ka mbajtur, gjatë kësaj periudhe, e plotësojnë kërkesën e pikës 2 gërma a të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000.

43. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në kuptim dhe zbatim të drejtë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, nisur nga të dhënat mbi kohëzgjatjen dhe llojin e veprimtarisë profesionale të ushtruar, arrin në përfundimin se zoti Artan Spahiu nuk plotëson kushtin që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike për të qenë kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Pavarësisht se kandidati ka në tërësi 20 vjet, 3 muaj dhe 12 ditë vjetërsi në punë nuk rezultoi që, nga totali i kësaj vjetërsie, të kishte të paktën 15 vite përvojë pune në pozicionet e kërkuara nga Neni 125 i Kushtetutës dhe Neni 7/a i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.

44. Në ndryshim nga sa ka parashtruar kandidati në shpjegimet e tij, se eksperiencia 20 vjeçare e justifikon kërkesën e pikës 4 të Nenit 125 të Kushtetutës dhe pikës 2 gërma a të Nenit 7/a të Ligjit 8577, Këshilli çmon se vjetërsia në punë (të paktën 15 vjet) është e lidhur ngushtë me pozicionin e punës që duhet të mbajë kandidati gjatë kësaj periudhe, e cila duhet të jetë nga ato të cilat janë të përcaktuara qartë në këto dispozita: gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike dhe nuk duhet të merret e shpëputur prej saj. Nëse kandidati nuk i përmbush të dy këto kërkesa njëherësh, pra edhe vjetërsinë të paktën 15 vjet, edhe pozicionin e punës të përcaktuar për të mbajtur gjatë kësaj periudhe vjetërsie, kandidati nuk plotëson kushtin e kërkuar nga Neni 125 i Kushtetutës dhe Neni 7/a i ligjit Nr. 8577/2000.

45. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Këshilli vlerëson se periudha “10 Gusht 1999 – 28 Mars 2010”, kohë në të cilën kandidati ka qenë në marrëdhënie pune pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, në pozicionin: Inspektor Jurist pranë Zyrës Juridike; Jurist në Drejtorinë e Kontrollit Financiar; Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Financiar dhe Inspektor Jurist në Sektorin e Auditit të Brendshëm, nuk konsiderohet si periudhë vjetërsie për efekt të plotësimit të kërkesave të Nenit 125 të Kushtetutës dhe Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, pasi asnjë prej pozicioneve që ka mbajtur kandidati Artan Spahiu në këtë periudhë nuk përfshihet në kategorinë e “Nëpunësit” apo “Juristit të nivelit të lartë në administratën publike”.

46. Në kohën kur kandidati Artan Spahiu ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Prefekturës së Qarkut Elbasan, ka qenë në fuqi ligji Nr. 7608, datë 22.09.1992 “Për Prefekturat”, në zbatim të të cilit ka dalë VKM Nr. 202, datë 26.03.1998 “Për detyrat e aparatit administrativ të Prefekturës”, ku parashikohet edhe struktura organike e institucionit të Prefekturës, e organizuar në zyra dhe sektorë. Sipas kësaj strukture, Zyra e Financë Kontrollit përbëhej nga Përgjegjës zyre dhe inspektorë, dhe Zyra Juridike përbëhej nga Përgjegjës zyre dhe inspektor jurist. Kjo strukturë duhet të ketë qenë edhe për Prefekturën e Qarkut Elbasan, në të cilën kandidati ka shtruar detyrën si Inspektor, Jurist dhe Inspektor jurist dhe në asnjë rast kandidati nuk rezulton të ketë ushtruar detyrën si përgjegjës zyre apo përgjegjës sektori,

pozicione për të cilat kandidati mund të pretendonte për punësim në nivel të lartë të administratës publike.

47. Për të përcaktuar nivelin e administratës në të cilën ka punuar kandidati, Këshilli është referuar në Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, i cili ka qenë në fuqi në kohën që kandidati ka qenë duke ushtruar detyrën “Jurist” dhe “Inspektor jurist” në sektorë të ndryshëm të Prefekturës të Qarkut Elbasan. Në kuptim të këtij ligji, neni 11 i tij, “Nëpunës i nivelit të lartë të administratës shtetërore” (edhe administrata e Prefektit është institucion i administratës shtetërore sipas nenit 2 pika 2 e ligjit), janë të gjithë personat e punësuar në administratën shtetërore e, për rrjedhojë, dhe atë publike, në pozicionin: Sekretar i Përgjithshëm, Drejtor Departamenti, Drejtor Drejtorie të Përgjithshme dhe Pozicionet e barasvlershme me tre të parat në institucionet e administratës publike qendrore apo vendore. Pozicioni i mbajtur nga kandidati Artan Spahiu, “Jurist”, “Inspektor” dhe “Inspektor jurist” në Prefekturë nuk klasifikohen si nëpunës apo jurist i nivelit të lartë në administratën publike. I njëjti klasifikim ka vijuar të jetë edhe me ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 19 të tij. Gjithashtu, në referimin të VKM Nr.142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, termi inspektor barazohet me atë të specialistit, që është kategoria më e ulët e nëpunësit civil në administratën shtetërore dhe publike.

48. Për sa më sipër, pozicionet e punës të mbajtura nga kandidati Artan Spahiu, gjatë periudhës 10 Gusht 1999 - 28 Mars 2010, në Prefekturën e qarkut Elbasan, nuk përfshihen në kategorinë e pozicionit “Jurist i nivelit të lartë të administratës publike”.

49. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton gjithashtu se, edhe periudha në vijim nuk përmbush njëherësh kërkesat për vjetërsinë dhe pozicionin e kërkuar për të mbajtur në këtë vjetërsi. Gjatë periudhës 06.05.2010 – 21.10.2010, si dhe 01.11.2010 – 22.11.2019 (data e shpalljes së vakancës), gjithsej 9 vite, 5 muaj dhe 26 ditë, kandidati ka mbajtur pozicione të cilat vlerësohen si “Nëpunës i nivelit të lartë të administratës publike” dhe si Lektor i së drejtës, por kjo periudhë nuk përmbush kërkesën e kohëzgjatjes të paktën 15 vjet, e përcaktuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe pika 2 e Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000.

50. Në përfundim, Këshilli konkludon se kandidati Artan Spahiu nuk ka ushtruar të paktën 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, në zbatim të Nenit 237 të ligjit Nr. 115/2016, ky kandidat gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për mospërmbushje të kushtit ligjor të veprimtarisë profesionale 15-vjeçare në njërin ose bashkërisht në ato të gjyqtarit, prokurorit, avokatit, lektorit të së drejtës, nëpunës (jurist) të nivelit të lartë në administratën publike.

51. Këshilli vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit, kjo përbën motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

52. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidatin Artan Spahiu është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësisimit të kushtit ligjor të përcaktuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, Këshilli vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit.

53. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Artan Spahiu, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të pikës 1 të Nenit 149/d dhe Nenit 125 të Kushtetutës, të Nenit 7/a dhe 7/b të ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të pikës 3 të Nenit 229, pikës 4 të Nenit 235, pikës 5 të Nenit 236 dhe pikës 3 të Nenit 237 të Ligjit Nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Artan Spahiu, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.
2. Në zbatim të Nenit 238 të Ligjit Nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Artan Spahiu.
3. Kandidati Artan Spahiu ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**ZËVENDËSKRYETARE**

**Vitore TUSHA**

## MENDIM PAKICE

Anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, SAIDA DOLLANI, sipas nenit 47 të Vendimit nr.4/2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në motivet kundër vendimit të marrë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me nr.26, datë 16.09.2020 për ndalimin e kandidimit të z. Artan Spahiu për pozicionin e Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, ekspozoj argumentat e mendimit në pakicë si vijon.

1. Referuar vendimit të shumicës, është e qartë se Kandidati Artan Spahiu është ndaluar për mosplotësimin e **kriterit të meritës profesionale** prej 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

2. Pakica vlerëson se duke u parashikuar merita profesionale prej ‘15 vjet përvojë pune’ si kriter (pra jo si kusht ligjor) nga neni 7/a pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, **shqyrtimi i meritës profesionale nuk i përket fazës së verifikimit por i përket fazës së mëvonshme, asaj të vlerësimit.**

3. Neni 149/d i Kushtetutës së Republikës parashikon në mënyrë eksplicite në pikën 1, se: **‘1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati’.**

4. Pikërisht, në bazë të këtij parimi Kushtetues, ligjvënësi i zakonshëm ka nxjerrë ligjin nr. 115/2016 ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’, Pjesa V e të cilit i dedikohet Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të cilin neni 218 pika 1 e ligjit nr. 115/2016, përcakton se: **‘Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është organ i pavarur që verifikon përmbushjen e kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionale e morale të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë’.**

5. Pjesa V e ligjit nr. 115/2016 ndahet në gjashtë Krerë, ku Kreu IV parashikon rregullat për verifikimin e kushteve ligjore të kandidatëve ndërsa Kreu V parashikon vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve. Nga leximi i normave në mënyrë koherente qartësisht vërehet se veprimtaria e vlerësimit të kandidatëve për vendet e lira në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë kalon nëpër dy faza:

a) **Faza e parë është ajo e verifikimit të kushteve ligjore të kandidatëve për të cilat parashikojnë rregullat e neneve 234-238 të ligjit nr. 115/2016 si dhe rregullat nënligjore të parashikuara në vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.**

**b) Faza e dytë është ajo e vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve, për të cilat parashikojnë rregullat e neneve 239-240 të ligjit nr. 115/2016 si dhe rregullat nënligjore të parashikuara në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërimet në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.**

6. Rrjedhja llogjike –juridike e arsyetimit të paragrafëve të mësipërm është se në fazën e verifikimit të kushteve ligjore Këshilli verifikon vetëm kushtet e përcaktuara në nenet 234, 235, 236, 237 të ligjit 115/2016 si dhe kushtet e parashikuara nga neni 7/a pika 1 e ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar, tek i cili referon në mënyrë të shprehur ligji nr. 115/2016. Nëse kandidatët kanë sukses në plotësimin e kushteve ligjore, pra pas përfundimit të procedurës së verifikimit, sipas parashikimeve të neneve 234 deri në 238, të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vijon me vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve dhe bën renditjen e tyre (neni 239 i ligjit 115/2016).

7. Për sa ka argumentuar më sipër, pakica vjen në përfundimin se nuk përbën kusht ligjor mospasja e kriterit të *15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës*, për çka dhe nuk mund të verifikohet në këtë fazë të procedurës por vlerësohet në fazën e mëpasëshme të saj.

**ANËTARE**

**SAIDA DOLLANI**

